VENDIM
Nr. 81, datë 16.9.2014

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "ALBANIAN GENERAL ELEKTRICITY" SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR NJË AFAT 5-VJEÇAR

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa "a", 9 dhe 13 pika 1 germa "d", të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa "g", 5 pika 2, 8 dhe 13 dhe 14 pika 1, të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 16.9.2014, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Albanian General Elektricity" sh.p.k. si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

KONSTATOI SE:

Aplikimi i shoqërisë "Albanian General Elektricity" sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9 pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4/10 germat "a", "b" dhe "c") është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë "Albanian General Elektricity" sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti